



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 481 prot.

Tiranë, më 18 . 03 . 2022

V E N D I M

Nr. 54 , datë 18 . 03 . 2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 139 Regj., datë 27.07.2021, të shtetasit A. B³, kundër Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionit (DVKM) Gjirokastrë⁴ dhe Departamentit për Kufirin dhe Migracionin (DKM), me pretendimin e diskriminimit për shkak të “gjendjes civile” dhe “gjendjes gjyqësore⁵”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O N :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Mbështetur në deklaratimet, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur ankesës, rezulton se, subjekti ankues, A. B, më datë 02.02.2010 ka ndërruar emrin nga R. B në R. B, dhe më datë 26.08.2011, ka ndërruar emrin nga R. B në A. B.

Në parashtrimet e sjella para Komisionerit, ankuesi shprehet se, sa herë del jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në pikat e kalimit kufitar e kontrollojnë në mënyrë të imtësishme, siç nuk ndodh me personat e tjerë. Sipas ankuesit:

“Punonjësit e policisë kufitare ushtrojnë kontroll fizik trupor dhe të sendeve personale të miat, duke më veçuar nga personat e tjerë, vetëm për faktin se kam ndërruar emrin. Ata më drejtohen me fjalët: “Çne ti e ke ndërruar emrin dy herë, do kesh bërë ndonjë gjë ti, dil veçantë të të

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose si Komisioneri.

³ Bazuar në Prokurën e Përgjithshme me nr. repertori 2714, nr. koleksioni 966, datë 08.07.2021, subjekti ankues përfaqësohet nga av. A. Ç dhe av. M. P.

⁴ Në pikën kufitare Kakavijë.

⁵ Klasifikuar tek “çdo shkak tjetër”.

kontrollojmë njëherë ty!”. Në këtë mënyrë punonjësit e policisë më vonojnë, më tallin dhe i gjithë procesi është fyles ndaj meje. Këto veprime kanë ndodhur në prani të familjarëve dhe të miqve të mi. Hera e fundit që ka ndodhur është më datë 11 korrik 2021, në pikën kufitare të Kakavijës”.

Ankuesi shprehet se kjo situatë është kthyer në ankth për të dhe se e ka dëmtuar moralisht duke bërë që të ndihet i fyer dhe i poshtëruar, ndërkohë që nuk ka kryer asnjë vepër penale apo shkelje administrative. Ai pohon se, ky trajtim i bëhet për faktin e ndryshimit të emrit, dhe i bëhet vetëm në pikat kufitare të Republikës së Shqipërisë dhe në asnjë nga vendet e tjera të huaja ku ka udhëtuar.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi: “...të zhvillojë një hetim ...të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, si dhe të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme që këto veprime të mos përsëriten në të ardhmen ndaj tij”.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së⁶, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të LMD-së, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

⁶Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 1126/1 prot., datë 10.08.2021, Komisioneri ka njoftuar dhe i ka kërkuar parashtrime, Departamentit për Kufirin dhe Migracionin (DKM), lidhur me pretendimin e subjektit ankues, si dhe dokumentacionin poshtë cituar:
 - Cila është praktika që ndjek punonjësi i policisë së pikës kufitare të DRKM-ve, lidhur me kontrollin fizik të personave apo dhe sendeve të tyre personale.
 - Në parim dhe rast pas rasti, cila është praktika që ndjek punonjësi i policisë së pikës kufitare të DRKM-ve, lidhur me kontrollin fizik të personave që kanë ndryshuar emrat apo dhe sendeve të tyre personale.
 - Cila është praktika që ka ndjekur punonjësi i policisë së pikës kufitare të DRKM Gjirokatër (në pikën kufitare Kakavijë) lidhur me kontrollin fizik dhe sendeve personale, të shtetasit A. B, më datë 11.07.2021. Informacion nëse mund të disponohen pamje filmike të kamerave lidhur me rastin konkret.
 - Ku është e parashikuar praktika/procedura e kontrollit fizik të personit dhe sendeve të tij personale në pikat kufitare të DRKM? Kopje të akteve shkresore.
 - Si veprohet nga punonjësi i policisë kufitare, në raste analoge me persona të tjerë, që rezulton të kenë ndryshuar emrat e tyre? Shembuj të rasteve konkrete, nëse ka.
 - Informacion lidhur me mënyrën dhe periudhën e ruajtjes të të dhënave personale, për personat që rezulton se kanë ndryshuar emrat e tyre, nga ana e Policisë së Kufirit dhe Migracionit, si dhe procedura që ndiqet dhe praktika e krijuar lidhur me këtë fakt (Baza ligjore e aplikuar lidhur me sa më sipër).
 - Si dhe çdo informacion dhe dokumentacion provues, që ju çmoni se ndihmon në sqarimin e kësaj problematike të përcjellë nga ankuesi.
- Nëpërmjet shkresës me nr. 2742/3 prot., datë 16.08.2021, subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, DKM, ka njohur Komisionerin me qëndrimin e tij, përse i takon pretendimeve të ankuesit, duke parashtruar si më poshtë vijon:

“Nga verifikimet e kryera nga ana jonë, referuar pretendimit të shtetasit A. B, se gjatë kalimit të kufirit me datë 11 korrik 2021 në (Pikën e Kalimit Kufitar) PKK Kakavijë është kontrolluar në mënyrë diskriminuese, ju informojmë se, shtetasi A. B nuk ka regjistrim hyrje/dalje në PKK Kakavijë, në këtë datë. Ky shtetas, referuar regjistrimeve në sistemin TIMS, rezulton se ka kaluar kufirin me datë 09.07.2021, ora 22:59 dhe është regjistruar në sistem nga kontrollori E. V, me të dhëna përkatësisht:

A. K. B	BD1329621	Z	25.04.1973	M	X AUTOVETURË	09.07.2021 22:59:00	E.V
---------	-----------	---	------------	---	--------------	------------------------	-----

Nga verifikimi i pamjeve të kamerave të sigurisë rezulton se, kontrolli në vijën e parë të këtij shtetasi dhe automjetit të tij, janë bërë konform procedurave standard.

Referuar të dhënave të sistemit TIMS, ky shtetas rezulton se ka këto rekorde si më poshtë:

- Raport ngjarje për një plagosje me armë zjarri me datë 09.06.2011;

- *Eshtë refuzuar tre herë për të dalë jashtë shtetit për shkak se nuk ka qenë i pajisur me dokumentacionin e nevojshëm për të udhëtuar në zonën Shengen;*
- *Rezulton se është kthyer deportiv me datë 16.05.2018, nga autoritetet e migracionit të Belgjikës dhe në sistem është shënuar: “Kthyer deportiv nga Belgjika pasi është akuzuar për lëndë narkotike, ndalim 10 vjet”.*
- *Është verifikuar në vijën e dytë të kontrollit në tre raste, dhe pasi ka rezultuar pa probleme është lejuar të udhëtojë.*

Lidhur me sa më sipër, referuar gjithë të dhënave për këtë shtetas, për çdo punonjës të policisë kufitare që kryen procedurën e regjistrimit në sistem për kontrollin e kalimit të kufirit, këtë shtetas do të duhet që ta verifikojnë me vëmendje të shtuar dhe të vlerësojnë çdo element të të dhënave rreth tij”.

Në përgjigjen e DKM, citohet se ky proces verifikimi bazohet në:

- Ligjin nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar”, neni 6, pika 1⁷, neni 14, pikat 1, 6 dhe 7⁸ të tij;
- VKM nr. 746, datë 26.10.2016 “Për kryerjen e verifikimeve të përbashkëta kufitare”;
- Urdhri nr. 641, datë 20.12.2019 “Për forcimin e kontrollit të shtetasve shqiptarë që kalojnë kufirin shtetëror”, të Ministrit të Brendshëm, pikat 1,2,3 të tij;
- Procedura Standarde e Punës së Policisë Kufitare me titull: “Procedurat e Punës për verifikimin kufitar në PKK dhe PPKK” (Pikat e Kalimit Kufitar dhe Pikat e Përbashkëta të Kalimit Kufitar), me nr. 165, datë 08.02.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, pikat 1.1.1., 1.2.5 dhe 2 të tij.

Lidhur me kërkesën e KMD-së, për praktikën që ndiqet për kontrollin fizik të personave që kanë ndryshuar emrin, DKM, ka informuar se, nuk ka asnjë procedurë për këto raste, dhe se kryhet një verifikim minimal për t’u garantuar në vërtetësinë e gjeneraliteteve dhe asgjë më shumë.

⁷Kompetencat e Policisë Kufitare dhe të Migracionit në kufi

“Rojat kufitare, në kuadër të kontrollit kufitar, janë të autorizuar të verifikojnë identitetin e personave, subjekt kontrolli, arsyen për kalimin e kufirit shtetëror, si dhe automjetet e sendet e tyre, nga jashtë dhe nga brenda. Çdo person është i detyruar të bashkëpunojë në verifikimin e identitetit e të arsyeve të kalimit të kufirit shtetëror, të mundësojë zbatimin e menjëhershëm të kësaj mase, si dhe të sigurojë që automjeti e sendet e tij të mund të verifikohen”.

⁸ Verifikimi kufitar i personave

“Në hyrje dhe në dalje, të gjithë personat janë subjekt i verifikimit kufitar minimal, i cili përbëhet nga:
a) verifikimi i identitetit e i shtetësisë së personit, si dhe i vlefshmërisë e i origjinalitetit të dokumentit të udhëtimit, duke përdorur pajisje teknike dhe duke u konsultuar me bazat përkatëse të të dhënave e veçanërisht me:
i) bazat kombëtare të të dhënave që përmbajnë informacion mbi dokumentet e vjedhura, të përvetësuara, të humbura dhe të zhvleftësuara të udhëtimit;
ii) bazën e të dhënave të INTERPOL-it për dokumentet e vjedhura dhe të humbura të udhëtimit;
iii) bazat ndërkombëtare të të dhënave, të njohura nga Republika e Shqipërisë;
b) verifikimi që personi, mjeti i tij i transportit dhe sendet që ai transporton nuk përbëjnë rrezik për rendin dhe sigurinë publike, shëndetin publik dhe marrëdhëniet ndërkombëtare me shtetet e tjera, duke u konsultuar me regjistrat dhe bazat e të dhënave përkatëse.

Kur ka dyshime mbi origjinalitetin e dokumentit të udhëtimit ose mbi identitetin e mbajtësit të tij, në verifikime përfshihet verifikimi i identifikuesve biometrikë të integruar në pasaportat dhe dokumentet e udhëtimit. Personat, që janë subjekt i verifikimit kufitar minimal, në bazë të analizës së riskut dhe në mënyrë josistematike, mund t’i nënshtrohen verifikimit tërësor.

Nëse, nga rezultatet e verifikimit në vijën e parë, konsiderohen të nevojshme verifikime të mëtejshme, personit i kërkohet t’i nënshtrohet verifikimit në vijën e dytë, i cili mund të përfshijë verifikime të hollësishme personale, verifikime të hollësishme të sendeve në posedim dhe inspektime të hollësishme të automjetit”.

Lidhur me administrimin e të dhënave që regjistrohen gjatë kalimit të kufirit, DKM, bën me dije se, policia kufitare bazohet në nenin 20, të ligjit nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar”, si dhe tek Udhëzimi i Përbashkët i Ministrisë të Brendshme dhe i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me nr. 515, datë 27.09.2016 “Për përpunimin e të dhënave personale nga rojet kufitare”. (Lidhur me ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave personale të shtetasve).

2. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 1126/3 prot., datë 11.10.2021, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore.

Seanca u zhvillua në datën 26.10.2021, pranë Zyrës së Komisionerit, me pjesëmarrjen e subjektit ankues dhe përfaqësuesve të tij ligjorë av. M. P dhe av. A. Ç, si dhe përfaqësuesit të DKM-së, Kryekomisar B. Z.

Pala ankuese u qëndroi të njëjtave pretendime për trajtim të padrejtë e diskriminues nga ana e DVKM Gjyrokastër dhe DKM, të parashtruara si në ankesën e sjellë pranë KMD-së.

Nga ana e përfaqësuesit të DKM u mbajt i njëjti qëndrim si ai i bërë i ditur nëpërmjet përgjigjes shkresore drejtuar Komisionerit, duke theksuar faktin se ankuesi në asnjë moment nuk është ndaluar dhe nështruar kontrollit nga punonjësi i pikës kufitare për shkak të ndryshimit të emrit të tij, por për shkak të të dhënave që rezultojnë në sistem për të, duke cituar faktin se ai kishte qenë deportiv dhe më rekorde të tjera. Gjithashtu, ai bëri të ditur faktin se të gjitha të dhënat që rezultojnë në emër të tij, aktualisht janë fshirë nga sistemi dhe tani ai rezulton pa shënimet përkatëse që ishin deri ditën që ishte ushtruar kontrolli i fundit, me datë 09.07.2021, në PKK Kakavijë.

Nga ana e palës ankuese u kërkua që të shtohet si shkak i pretenduar diskriminimi nga ana e DKM, edhe “gjendja gjyqësore” e ankuesit, pasi ai nuk kishte qenë asnjëherë i dënuar në asnjë nga shtetet e BE apo në Republikën e Shqipërisë.

Në këto kushte iu kërkua DKM të sillte në vijim, pranë KMD-së parashtrime dhe dokumentacion shtesë, si më poshtë:

- Parashtrime lidhur me sa ka pretenduar subjekti ankues, për pretendimin për diskriminim për shkak të “gjendjes gjyqësore”.
- Shpjegime dhe argumentime, lidhur me kontrollin fizik që i është bërë subjektit ankues dhe automjetit të tij, në prani të familjarëve që e shoqëronin në këtë udhëtim, në pikën kufitare të DVKM Gjyrokastër, më datë 09.07.2021.
- Nëse mund të vini në dispozicion pamjet filmike respektive që lidhen me këto momente.
- Në shkresën me nr. 2742/3 prot., datë 16.08.2021, drejtuar Komisionerit, keni cituar se: “Referuar regjistrimeve në sistemin TIMS, rezulton se ankuesi ka kaluar kufirin me datë 09.07.2021, ora 22:59”. Në kontekst të orarit (orës 22:59) të kalimit të kufirit shtetëror, ju lutem të saktësoni sa kohë ka zgjatur kontrolli i imtësishëm i subjektit ankues. Nëse mundeni ta dokumentoni atë.

- Kopje të procesverbalit të mbajtur nga punonjësit e policisë së DVKM Kakavijë, pas përfundimit të kontrollit të imtësishëm të subjektit ankues dhe automjetit të tij, nëse ka. Kopje të fletës së regjistratit ku është evidentuar ky kontroll.
- Cila është praktika që ka ndjekur Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DKM), lidhur me verifikimin e ankesës në fjalë, veprimeve dhe procedurës së ndjekur nga punonjësi i policisë së pikës kufitare të DVKM Gjirokatër (në pikën kufitare Kakavijë) lidhur me kontrollin fizik dhe sendeve personale, të shtetasit A. B, më datë 09.07.2021?
- Kopje të procedurës së ndjekur lidhur me verifikimin e rastit (procesverbalë të mbajtur, urdhra, akte provuese që kanë iniciuar dhe shoqëruar këtë procedurë).
- Parashtrimet tuaja lidhur me shpjegimin e dokumentimin e procedurës së ndjekur për cilësimin e ankuesit si DEPORTIV, në sistem.
- Cili është autoriteti përgjegjës që bën një verifikim të të dhënave të individit (ankuesit në rastin konkret) dhe cilësim të tillë në sistem?
- Cili është autoriteti përgjegjës për plotësimin e të dhënave tek rubrika “Shënime” në sistemin TIMS?
- Në këtë kuadër, të jepen shpjegime dhe informacion lidhur me shënimin “*Raport ngjarje për një plagosje me armë zjarri me datë 09.06.2011*”. Cili është autoriteti që ka tagrin për të hedhur në sistem një të dhënë të tillë, si dhe kopje të akteve që provojnë këtë fakt.
- A ka një afat kohor të përcaktuar, se për sa kohë duhet të qëndrojnë të cilësuar në sistemin TIMS të dhëna të tilla? Nëse po, sa është ky afat kohor dhe ku parashikohet një fakt i tillë?
- Kopje të dokumentacionit (në formën e kërkuar nga ligji) që provon se ankuesi nuk ka ndalim hyrjeje, urdhër largimi apo dëbimi në vendet e Bashkimit Evropian dhe zonën Shengen, dhe që ai duhet të ketë paraqitur në PKK Kakavijë, në momentin e kalimit.
- Nëse nuk ka paraqitur një dokument të tillë, dhe DKM ka argumentuar se personi ka qenë DEPORTIV, cila është arsyeja që ai është lejuar të kalojë kufirin shtetëror në drejtim të shteti grek? Shpjegimet tuaja.
- Si dhe çdo informacion dhe dokumentacion provues, që ju çmoni se ndihmon në sqarimin e kësaj problematike të përcjellë nga ankuesi.

3. Nëpërmjet shkresës me nr. 1126/4 prot., datë 28.10.2021, Komisioneri iu drejtua sërish DKM-së, duke i rikujtuar të sillte informacionin dhe dokumentacionin respektiv, në vijim të detyrave të lëna në seancën dëgjimore të datës 26.10.2021.

➤ Nga ana e DKM nuk u soll asnjë përgjigje apo dokumentacion i kërkuar nga ana e KMD-së.

4. Lidhur me gjykimin me objektivitet të çështjes, si dhe për krijimin e një panorame sa më të plotë të kuadrit ligjor dhe kompetencave lëndore lidhur me sa më sipër, nëpërmjet shkresës me nr. 1126/5 prot., datë 29.12.2021, Komisioneri iu drejtua Ministrisë së Brendshme (MB), duke i kërkuar respektivisht, si më poshtë:

- Parashtrime lidhur me shpjegimin e dokumentimin e procedurës së ndjekur për cilësimin e ankuesit si DEPORTIV, në sistem.

- Cili është autoriteti përgjegjës që bën një verifikim të të dhënave të individit (*ankuesit në rastin konkret*) dhe cilësim të tillë në sistem?
 - Cili është autoriteti përgjegjës për plotësimin e të dhënave tek rubrika “Shënime” në sistemin TIMS?
 - Në këtë kuadër, të jepen shpjegime dhe informacion lidhur me shënimin “*Raport ngjarje për një plagosje me armë zjarri me datë 09.06.2011, në emër të shtetasit A. B*”. Cili është autoriteti që ka tagrin për të hedhur në sistem një të dhënë të tillë, si dhe kopje të akteve që provojnë këtë fakt.
 - A ka një afat kohor të përcaktuar, se për sa kohë duhet të qëndrojnë të cilësuar në sistemin TIMS të dhëna të tilla? Nëse po, sa është ky afat kohor dhe ku parashikohet një fakt i tillë?
 - Kopje të dokumentacionit (në formën e kërkuar nga ligji) që provon se ankuesi nuk ka ndalim hyrjeje, urdhër largimi apo dëbimi në vendet e Bashkimit Evropian dhe zonën Shengen, dhe që ai duhet të ketë paraqitur në PKK Kakavijë, në momentin e kalimit.
 - Nëse nuk ka paraqitur një dokument të tillë, dhe DKM ka argumentuar se personi ka qenë DEPORTIV, a duhet të ishte lejuar të kalojë kufirin shtetëror në drejtim të shteti grek? Shpjegimet tuaja.
 - Si dhe çdo informacion dhe dokumentacion provues, që ju çmoni se ndihmon në sqarimin e kësaj problematike të përcjellë nga ankuesi.
- Lidhur me sa më sipër, nga ana e MB, Komisionerit nuk iu kthye asnjë përgjigje shkresore.
 - Në përgjigje të shkresës me nr. 1126/5 prot., datë 29.12.2021, të Komisionerit, DKM nëpërmjet shkresës me nr. 33 prot., datë 06.01.2022, ka argumentuar ndër të tjera se:

“Referuar të dhënave në sistemin TIMS, ky shtetas rezulton me rekordet e cituara dhe në komunikimet e mëparshme të DKM me Komisionerin, dhe se, referuar këtyre të dhënave të mësipërme, për çdo punonjës të Policisë Kufitare që kryen procedurën e regjistrimit në sistem, për kontrollin e kalimit të kufirit, këtë shtetas do të duhet që ta verifikojë me vëmendje të shtuar dhe të vlerësojë çdo element të të dhënave të tij.

...Autoriteti përgjegjës për plotësimin e të dhënave tek rubrika “Shënime” në sistemin TIMS, lidhur me rastin konkret të shtetasit A. B, të kthyer deportiv nga Belgjika në aeroportin e Rinasit me datë 16.05.2018, është specialisti përkatës në Komisariatin e Policisë Kufitare Rinas, në bazë të dokumentacionit shoqërues nga policia belge.

...Heqja e shënimeve në sistem kryhet nga Drejtoria e Menaxhimit të Informacionit dhe Mbrojtjes së të Dhënave, me kërkesë të qytetarit, kur ka marrë një dokument nga një vend i BE-së që nuk ka probleme me sistemin Schengen dhe kur mbush afatin prej 3 (tre) vjetësh. Për rastin konkret, shtetasi ka paraqitur kopje të dokumentacionit që provon që nuk ka ndalim në zonën Schengen.

...Bazuar në pikën 3, të Urdhrit nr. 641, datë 20.12.2019, të Ministrit të Brendshëm, punonjësi i policisë kufitare në Stacionin e Policisë Kakavijë, nuk e ka penguar qytetarin të udhëtojë por, nisur nga shënimet në sistem e ka kaluar shtetasin për kontroll më të detajuar, në vijën e dytë, vazuar në procedurën standarde në fuqi”.

DKM, gjithashtu, bën me dije Komisionerin se, aktualisht të gjitha shënimet për kalimin kufitar janë fshirë dhe shtetasi A. B nuk ka asnjë problem për hyrje-daljet në/nga Republika e Shqipërisë.

Nga dërgimi i të dhënave të printuara për ankuesin, pasqyrohen dy momente: se çfarë pasqyrohej në sistem para fshirjes të të dhënave të tij dhe pas fshirjes të tyre. *(këto dy momente do të analizohen në vijim të vendimit nga KMD).*

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri vlerësoi se, dokumentacioni dhe informacioni i administruar deri në këto momente nga KMD, nuk ishte i mjaftueshëm për të arritur në përfundimin nëse mbajtja e këtyre dy “ të dhënave” të ankuesit në sistemin TIMS, nga ana e DKM, është e ligjshme dhe e justifikuar objektivisht.

5. Duke konsideruar natyrën dhe specifikën e çështjes, si dhe për një mendim më të specializuar të organit kompetent lidhur me vlerësimin e klasifikimin e “të dhënave personale e sensitive” të subjekteve të këtyre të dhënave, nëpërmjet shkresës me nr. 126 prot., datë 18.01.2022, Komisioneri iu drejtua për një mendim më të specializuar, institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
6. Me shkresën me nr. 126/1 prot., datë 19.01.2022, Komisioneri kërkoi informacion dhe të dhëna shtesë nga DKM, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
7. Bazuar në sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, arriti në përfundimin se, procedurat për shqyrtimin e ankesës nr. 139 Regj., datë 27.07.2021, të shtetasit A. B, duhet të pezulloheshin deri në sigurimin e informacionit të kërkuar nga ana e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. *(Vendimi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me nr. 28, datë 24.01.2022 “Për pezullimin e procedurës administrative”).* Bazuar në nenin 85/3 të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: *“3. Në ato raste kur informacioni apo dokumentet e kërkuara nga palët janë të domosdoshme për shqyrtimin e pretendimit të ngritur nga vetë palët, procedura pezullohet deri në sigurimin e informacionit dhe palët njoftohen për këtë gjë”.*
8. Me shkresën me nr. 181/7 prot., datë 28.01.2022, DKM, dërgoi informacionin e kërkuar nga Komisioneri, duke parashtruar, ndër të tjera se:

“Në lidhje me pikën e parë të kërkesës së KMD, ku kërkohet data e regjistrimit të rekordit “Raport ngjarje për një plagosje me armë zjarri me datë 09.06.2011”, në sistemin TIMS, për subjektin ankues, bëjmë me dije se data e regjistrimit të këtij raporti është me datë 09.08.2011 dhe është regjistruar nga Komisariati i Policisë Fier.

Për pikën e dytë të kërkesës, lidhur me faktin se sa herë e ka kaluar kufirin shtetëror ankuesi, për periudhën kohore nga viti 2011 deri me datë 09.07.2021, ju informojmë se nga verifikimi në sistemin TIMS, ky shtetas për periudhën e sipërcituar ka të regjistruar gjithsej 104 hyrje dhe 102 dalje, në të gjitha pikat e kalimit kufitar të Republikës së Shqipërisë.

Për pikën e tretë, ku kërkohet kopje të dokumentacionit që faktohet kalimi i kufirit shtetëror nga ankuesi për në vendet e BE-së dhe zonën Schengen, sqarojmë se regjistrimi në sistemin total të informacionit të Policisë së Shtetit (TIMS) bëhet me dokumentin biometrik të udhëtimit (pasaportë

ose kartë identiteti) dhe nga roja kufitare nuk mbahet asnjë dokumentacion në hyrje/dalje në pikat e kalimit kufitar.

Lidhur me pikën ku kërkohet informacion se sa herë i është nënshtruar kontrollit të imtësishëm nga roja kufitare në PKK, shtetasi A. B, nga Drejtoria e Menaxhimit të Informacionit dhe Mbrojtjes të të Dhënave në Policinë e Shtetit, në zbatim të Udhëzimit të Përbashkët nr. 515, datë 27.09.2016 “Për përpunimin e të dhënave personale nga rojet kufitare”, janë fshirë të gjitha shënimet për kontrollet në sistemin TIMS, kështu që është e pamundur të nxjerrim kontrollet në vijën e dytë të kryera nga roja kufitare ndaj këtij shtetasi”.

9. Me shkresën nr. 130/1 prot., datë 04.02.2022, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDHP), lidhur me rastin në fjalë, ka informuar Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndër të tjera, se:

“Z. B ka paraqitur një ankesë edhe pranë Zyrës së KDIMDHP, në datën 27.07.2021, nëpërmjet së cilës ka kërkuar fshirjen ose kufizimin e aksesit mbi të dhënat që kanë të bëjnë me ndërrimin e emrit nga sistemi TIMS, i menaxhuar nga kontrolluesi për arsye të pretendimeve të tij lidhur me problematikat e hasura gjatë kalimit të kufirit.

Zyra e Komisionerit, me shkresën me nr. 128/1 prot., datë 30.07.2021, ka orientuar ankuesin, në lidhje me kushtin për respektimin e procedurës së parashikuar, e cila parashikon se subjekti i të dhënave mund të kërkojë nga kontrolluesi bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personale.

Komisioneri, lidhur me verifikimin e rastit, bazuar në shkresën e dërguar nga Kontrolluesi (me nr. 7036/1 prot., datë 08.09.2021) është informuar se janë marrë masat për fshirjen e të dhënave të ankuesit, duke cituar shprehimisht: “...referuar kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur për shtetasin A. B, u fshinë shënimet si deportiv dhe i verifikuar, pasi janë plotësuar afatet e ruajtjes, bazuar në aktet normative në fuqi”. Në këto kushte, Komisioneri vlerësoi se kërkesa e ankuesit është përmbushur nga ana e Kontrolluesit”.

KDIMDHP informoi gjithashtu se, z. B, lidhur me këtë rast ka paraqitur kërkesë-padinë nr. 4418 Akti, datë 26.10.2021, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kundër Zyrës së KDIMDHP dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me objekt: “Fshirje të dhënash personale, kufizim aksesit në lidhje me të dhënat personale”, kërkesë-padi e cila është akoma në fazë shqyrtimi gjyqësor.

10. Me vendimin nr. 52, datë 11.03.2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vendosi ndërprerjen e pezullimit dhe çeljen e procedurës administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 139, datë 27.07.2021, pasi u administruan parashtrimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDHP).

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm të ankuesit.

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse subjekti ankues është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me shtetas/individë të tjerë në një situatë të njëjtë apo të ngjashme me të, nevojitet “krahasuesi”.

Mirëpo, në kushtet kur ky “krahasues” mungon, vlerësohet nëse ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë në raport me parashikimet ligjore.

Në këtë kontekst, Komisioneri ka analizuar dhe vlerësuar trajtimin që institucioni shtetëror, i ka bërë ankuesit në raport me të drejtat e tij ligjore, nëpërmjet veprimeve apo mosveprimeve të tij.

Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e ankuesit, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar⁹ ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast SHSSH, i cili duhet të provonte se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, për shkakun e pretenduar prej tij.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“ Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”*.

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”*.

⁹Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

A/1. Lidhur me trajtimin e padrejtë të ankuesit nga ana e DVKM Gjirokastrë dhe DKM, për shkak të gjendjes civile (ndryshimit të emrit disa herë nga ana e tij në Gjendjen Civile).

Në kontekst të legjitimitetit të ankuesit kundrejt subjekteve ndaj të cilëve ka pretenduar diskriminimin, Komisioneri vëren se, bazuar në kompetencat e sanksionuara nga ligji nr.71/2016 “Për Kontrollin Kufitar¹⁰” dhe aktit nënligjor në zbatim të tij¹¹, Udhëzimit të Përbashkët me nr. 515, datë 27.09.2016 “Për Përpunimin e të Dhënave Personale nga Rojet Kufitare”, të Ministrisë të Brendshme dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, DKM, gëzon legjitimitet pasiv në këtë proces, pasi ka tagrin ligjor për marrjen e masave për zbatimin e afateve të ruajtjes, aksesimit dhe anonimizimit të pakthyesëm apo fshirjes së të dhënave personale që përpunohen në arkivat elektronike për efekt të kontrollit kufitar.

Nga ana tjetër, DVKM Gjirokastrë nuk gëzon legjitimitet pasiv për kërkimin e ankuesit për fshirjen e të dhënave nga sistemi i përpunimit të të dhënave, pasi nuk ka tagrin e fshirjes të të dhënave të tilla nga sistemi, por gjithsesi veprimet dhe procedura e ndjekur nga ana e DVKM Gjirokastrë do të shqyrtohet dhe vlerësohet nga Komisioneri në funksion të një hetimi sa më të plotë dhe një konkluzioni të drejtë dhe që, mund t’i shërbejë DKM si organ epror në zbatimin e drejtë të ligjit nr. 71/2016 “Për Kontrollin Kufitar” dhe Udhëzimit të Përbashkët me nr. 515, datë 27.09.2016 “Për Përpunimin e të Dhënave Personale nga Rojet Kufitare”.

Në këtë kontekst, Komisioneri, do të marrë në shqyrtim pretendimin e ankuesit, lidhur me trajtimin e padrejtë, e të pafavorshëm të tij nga ana e DKM.

Nga këqyrja e dokumentacionit dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezulton se:

Subjekti ankues ka kaluar kufirin në PKK Kakavijë me datë 09.07.2021, ora 22:59 dhe është regjistruar në sistem nga kontrollori E. V. Ai ka pretenduar se shkak për ndalimin dhe kontrollin e imtësishëm të tij dhe automjetit nga ana e punonjësit të PKK Kakavijë është bërë fakti se ai ka ndryshuar emrin në gjendjen civile disa herë, dhe se ai është ndjerë i fyer dhe i diskriminuar për këtë fakt.

¹⁰ Neni 20/3 i ligjit: “Rregullat për administrimin e të dhënave të grumbulluara nga zbatimi i këtij ligji përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

¹¹ Në zbatim të pikës 3, të nenit 20, të ligjit nr. 71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, Ministri i Punëve të Brendshme dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, kanë nxjerrë Udhëzimin e Përbashkët me nr. 515, datë 27.09.2016 ¹¹ “Për Përpunimin e të Dhënave Personale nga Rojet Kufitare”.

Lidhur me praktikën që ndiqet për kontrollin fizik të personave që kanë ndryshuar emrin, DKM, ka informuar se, nuk ka asnjë procedurë për këto raste, dhe se kryhet vetëm një verifikim minimal për t'u garantuar në vërtetësinë e gjeneraliteteve dhe se nga verifikimi i pamjeve të kamerave të sigurisë rezulton se, kontrolli në vijën e parë të këtij shtetasi dhe automjetit të tij, janë bërë konform procedurave standard.

Lidhur me qëndrimin e DKM për sa mësipër, Komisioneri vëren se, megjithëse i është kërkuar shprehimisht (në seancën dëgjimore të datës 26.10.2021, si dhe nëpërmjet shkresës me nr. 1126/4 prot., datë 28.10.2021) të viheshin në dispozicion të KMD-së pamjet filmike të momenteve të ndalimit dhe kontrollit të subjektit ankues, si dhe kopje të procesverbalit të mbajtur nga punonjësit e policisë së DVKM Kakavijë, pas përfundimit të kontrollit të imtësishëm të subjektit ankues dhe automjetit të tij, kopje të fletës së regjistrimit ku është evidentuar ky kontroll; nga ana e DKM nuk u sollën dokumentacion, prova apo argumente që të kundërshtonin pretendimet e ankuesit, apo justifikime të arsyeshme se përse nuk mund të viheshin në dispozicion të procedurës hetimore të zhvilluar nga KMD.

Megjithatë, pretendimi i ankuesit se ndalimi i tij nga punonjësi i PKK Kakavijë ka ardhur për shkak të ndërrimit të emrit të tij në gjendjen civile mbetet i karakterit deklarativ dhe i paprovuar. Ky fakt është kundërshtuar nga ana e subjektit ndaj të cilit është adresuar ankesa, DKM, me argumentin se, shkak për ndalimin e tij janë bërë “të dhënat” që rezultojnë në sistemin TIMS për të.

Bazuar mbi pretendimin e ankuesit lidhur me këtë shkak të cilësuar prej tij si “për shkak të gjendjes gjyqësore”, Komisioneri ka shqyrtuar këtë pretendim të tij bazuar mbi këtë shkak, duke e analizuar në mënyrë të detajuar në vijim të këtij vendimi.

E drejta për të ndryshuar emrin dhe mbiemrin është një e drejtë ligjore e çdo shtetasi shqiptar, sipas përcaktimeve të Kodit të Familjes dhe ligjit specifik me nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për Gjendjen Civile”, të ndryshuar. Në këtë kontekst, askush nuk mund të paragjykohet apo trajtohet në mënyrë të padrejtë, të pafavorshme e aq më tepër diskriminuese vetëm se ka ndryshuar emrin konform të gjitha parashikimeve ligjore që rregulojnë atë.

Thjesht dhe vetëm ndryshimi i emrit të individit sipas procedurave ligjore, nuk mund të përbëjë shkak që, përtej verifikimit të vlefshmërisë së dokumentit të identifikimit t'i nënshtrohet në vijimësi kontrolleve kufitare të thelluara.

Për më tepër, sipas akteve, ankuesi ka mbi 10 (dhjetë) vite që ka ndryshuar gjeneralitetet dhe me këtë identitet ka lëvizur herë pas here në pikat e kalimit kufitar, duke lënë gjurmët përkatëse në sistem.

Përsa i takon pretendimit të ankuesit se shkak për sjelljen diskriminuese të punonjësit të PKK Kakavijë është bërë ndryshimi i emrit disa herë në Gjendjen Civile, Komisioneri vlerëson se, nuk krijohet prezumimi mbi bazën e provave të drejtëpërdrejta apo të tërthorta të sjella nga ankuesi, që sjellja e punonjësit të PKK Kakavijë (ndalimi dhe kontrolli në vijën e dytë të PKK i ankuesit me datë 09.07.2021) të jetë motivuar nga ky shkak. Për rrjedhojë, Komisioneri nuk mund të shprehet se nga ana e punonjësit të PKK Kakavijë kundërshtojnë ankuesit, ka pasur sjellje të padrejtë, jo korrekte

apo diskriminuese, e cila mund të ishte nxitur për shkak se ai kishte ndryshuar disa herë emrin e tij në Gjendjen Civile.

A/2. Lidhur me trajtimin e padrejtë të ankuesit nga ana e DKM, për shkak të gjendjes gjyqësore¹² (të mbajtjes të të dhënave gjyqësore të ankuesit në sistemin e brendshëm të kontrollit kufitar dhe të menaxhuara në rastin konkret nga PKK Gjirokastrë dhe DKM).

Nga këqyrja e dokumentacionit dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezulton se:

Subjekti ankues ka kaluar kufirin në PKK Kakavijë me datë 09.07.2021, ora 22:59 dhe është regjistruar në sistem nga kontrollori E. V. Ai ka pretenduar se shkak për ndalimin dhe kontrollin e imtësishëm të tij dhe automjetit nga ana e punonjësit të PKK Kakavijë është bërë fakti se nga ana e autoriteteve përkatëse, PKK Kakavijë në rastin konkret, janë mbajtur të hedhura në sistem të dhëna gjyqësore të tij, të pasakta dhe në shkelje të akteve dhe afateve ligjore për administrimin e tyre.

Bazuar në parashtrimet e DKM lidhur me këtë fakt, është cituar se, referuar gjithë të dhënave për këtë shtetas, për çdo punonjës të policisë kufitare që kryen procedurën e regjistrimit në sistem për kontrollin e kalimit të kufirit, këtë shtetas do të duhet që ta verifikojnë me vëmendje të shtuar dhe të vlerësojnë çdo element të të dhënave rreth tij.

Në këtë kontekst, DKM është shprehur se referuar të dhënave në sistemin TIMS, ankuesi, ndër të tjera, rezulton me këto rekorde:

- Raport ngjarje për një plagosje me armë zjarri me datë 09.06.2011;
- Rezulton se është kthyer deportiv me datë 16.05.2018, nga autoritetet e migracionit të Belgjikës dhe në sistem është shënuar: “*Kthyer deportiv nga Belgjika pasi është akuzuar për lëndë narkotike, ndalim 10 vjet*”.

Përsa i takon të dhënave të cituara më lart, të cilat janë cilësuar si “rekorde” nga ana e DKM, Komisioneri ka kërkuar të njihet me informacionin lidhur me shënimin “*Raport ngjarje për një plagosje me armë zjarri me datë 09.06.2011*”, me dokumentacionin provues nëse ankuesi ka qenë i dënuar me vendim gjykate të formës së prerë, si dhe lidhur me momentin e dytë i cili cilëson ankuesin si të kthyer deportiv nga Belgjika, dokumentacion i cili nuk u vu në dispozicion të Komisionerit, për efekt të procedurës hetimore.

A.2.1 Lidhur me të dhënat e hedhura në sistemin TIMS dhe menaxhimin e tyre nga ana e institucionit përgjegjës, DKM, përsa i takon rekordit “Raport ngjarje për një plagosje me armë zjarri me datë 09.06.2011” Komisioneri vëren se:

Referuar dokumentacionit të depozituar nga ana e palës ankuese, rezulton e provuar se, nga vërtetimi i gjendjes gjyqësore (dëshmia e penaltetit) me nr. 30, datë 04.11.2021, i Minisistrisë së Drejtësisë, A. B, figuron si person i padënuar për kryerjen e ndonjë vepre penale në Republikën e Shqipërisë. Bazuar në sa më sipër, Komisioneri gjykon se raport ngjarja është një ndër hapat e parë proceduralë të përpiluara nga punonjësi/oficeri i policisë gjyqësore, që shërben për hetime dhe

¹² Cilësuar tek “*çdo shkak tjetër*”.

procedime të mëtejshme për një ngjarje penale. Është vetëm vendimi përfundimtar i gjykatës i cili përcakton pozitën e personit të dyshuar në raport me ngjarjen konkrete.

Mbajtja e kësaj të dhëne në sistem nga ana e DKM, (*thjesht vetëm raport ngjarja, e papërmbyllur me një vendim fajësie ndaj personit*), kur ai nuk është dënuar nga gjykata për asnjë vepër penale, apo kur kanë kaluar afatet e parashikuara në nenin 69, të Kodit Penal, mund të krijojë premisa për paragjykim të tij nga ana e punonjësit të PKK, duke bërë që ai t'i nënshtrohet një kontrolli të imtësishëm në vijën e dytë të kontrollit në PKK.

Tek çështja *S. dhe Marper*, GjEDNJ-ja doli në përfundimin se parimet thelbësore të instrumenteve përkatëse të Këshillit të Evropës dhe legjislacioni e praktika në fuqi e Palëve të tjera Kontraktuese, përcaktojnë që ruajtja e të dhënave të jetë proporcionale në raport me qëllimin e mbledhjes dhe e kufizuar në kohë, sidomos në sektorin e policisë. Sidoqoftë, kufizimi i kohëzgjatjes së ruajtjes së të dhënave personale gjen zbatim vetëm për të dhënat të cilat ruhen në një formë e cila mundëson identifikimin e subjekteve të të dhënave. Për këtë, ruajtja e ligjshme e të dhënave të cilat nuk nevojiten më, mund të bëhet duke anonimizuar ose pseudonimizuar të dhënat.

GJEDNJ, tek çështja *Cemalettin Canli kundër Turqisë*, gjeti shkelje të KEDNJ-së, lidhur me një raport policor të pasaktë në kuadër të një procedimi penal. Ankuesi ishte përfshirë dy herë në një procedim penal, për shkak se dyshohej se ishte anëtarësuar në organizata të jashtëligjshme, por nuk ishte dënuar kurrë.

GjEDNJ-ja¹³ vendosi se mbajtja në mënyrë të përgjithshme dhe pa dallim e të dhënave personale, pa afate kohore dhe kur individët e liruar kishin mundësi të kufizuar të kërkonin fshirjen e tyre, përbënte një cënim jo proporcional të të drejtës së ankuesit për respektim të jetës private, duke u shprehur ndër të tjera se: *“Çdo person duhet të ketë mundësi të ushtrojë të drejtën për akses në të dhënat në lidhje me të, të cilat janë objekt përpunimi, me qëllim që të verifikojë saktësinë e të dhënave dhe ligjshmërinë e përpunimit. Në përputhje me këto parime, subjektet e të dhënave duhet të gëzojnë të drejtën sipas legjislacionit kombëtar, për të kërkuar nga kontrolluesi korrigjimin, fshirjen apo bllokimin e të dhënave të tyre, nëse mendojnë se përpunimi i tyre nuk respekton dispozitat e Direktivës, sidomos për shkak të natyrës së pasaktë apo të mangët të të dhënave”*.

Komisioneri gjatë analizimit të legjislacionit, lidhur me trajtimin e çështjes objekt gjykimi pranë KMD-së, vlerëson se, e drejta për mbrojtje të të dhënave personale, bën pjesë në kompetencat lëndore të institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDHP).

Ligji nr.9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar, në nenin 1, të tij, ka përcaktuar se: *“Ky ligj ka për objekt përcaktimin e rregullave për mbrojtjen dhe përpunimin e ligjsëm të të dhënave personale”*.

¹³ GjEDNJ, *S. dhe Marper kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 30562/04 dhe 30566/04, 4 dhjetor 2008, parag. 119 dhe 125

Neni 29, pika 1, e këtij Ligji, ka përcaktuar se: “Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është autoriteti përgjegjës, i pavarur që mbikëqyr dhe monitoron, në përputhje me ligjin, mbrojtjen e të dhënave personale, dhe të drejtën e informimit duke respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”.

Kompetencat e KDIMDHP janë parashikuar në nenin 30, 31, 31/1, të Ligjit, si më poshtë citohet:

“ Komisioneri ka këto të drejta:

a) kryen hetim administrativ dhe ka të drejtën e aksesit në përpunimet e të dhënave personale, si dhe ka të drejtë të mbledhë të gjithë informacionin e nevojshëm për përmbushjen e detyrave të mbikëqyrjes;

b) urdhëron bllokimin, fshirjen, shkatërrimin ose pezullon përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale;

c) jep udhëzime përpara se përpunimet të kryhen dhe siguron publikimin e tyre.

2. Komisioneri, në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

2/1. Për rastet që shkelja përbën vepër penale, bën kallëzimin përkatës.

“1. Komisioneri është përgjegjës për:

.....

e) kontrollimin e përpunimit të të dhënave, në përputhje me ligjin, kryesisht ose me kërkesë të një personi edhe kur një përpunim i tillë është i përjashtuar nga e drejta e informacionit dhe vënien në dijeni të personit se kontrolli është kryer, si dhe verifikimin nëse procesi është i ligjshëm ose jo;

“ë) zgjidhjen e ankimeve të subjektit të të dhënave për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të tij, për përpunimet e të dhënave personale dhe vënien e tij në dijeni për zgjidhjen e ankesës së paraqitur”.

“Përveç përgjegjësiave të parashikuara në nenin 31, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ushtron edhe kompetencat e mëposhtme në fushën e së drejtës së informimit:

a) shqyrton kërkesat e personave, të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre të parashikuara në ligjin “Për të drejtën e informimit;

b) shqyrton ankesat e personave në lidhje me funksionimin e programeve të transparencës në autoritetet publike;

c) kryen hetimet e nevojshme administrative gjatë ushtrimit të kompetencave të tij;

ç) njihet dhe ka akses në informacionin dhe dokumentet, objekt ankimi, sipas ligjit për të drejtën e informimit apo që lidhen me çështjen në shqyrtim, duke përfshirë edhe informacionet e klasifikuara “sekret shtetëror”. Në këto raste, ai është i detyruar të respektojë kërkesat për ruajtjen e “sekretit shtetëror”, sipas legjislacionit në fuqi;

d) vendos sanksione administrative sipas parashikimeve të ligjit për të drejtën e informimit;

dh) nxit parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit;

e) monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit;

- ë) kryen sondazhe në lidhje me çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me të drejtën e informimit;
- f) bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës;
- g) me kërkesë të gjykatës që shqyrton çështjen, parashtron mendim me shkrim për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me të drejtën e informimit”.

Ligji nr. 71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, në nenin 20, pika 3¹⁴ e tij, ka përcaktuar se, rregullat për administrimin e të dhënave të grumbulluara nga zbatimi i këtij ligji përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Bazuar në sa më lart, Ministri i Punëve të Brendshme dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, kanë nxjerrë Udhëzimin e Përbashkët me nr. 515, datë 27.09.2016 ¹⁵“Për Përpunimin e të Dhënave Personale nga Rojet Kufitare”.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi referuar:

- parashikimeve të mësipërme të këtyre akteve ligjore;
 - faktit që KDIMDHP, është insitucioni që ka kompetencën ligjore për kontrollin, analizimin dhe vlerësimin nëse të dhënat personale mbahen në mënyrë ligjore e të justifikuar nga subjektet kontrolluese, DKM/DPPSH, në rastin konkret përsa i takon mbajtjes të të dhënës për raport ngjarjen e datës 09.06.2011 të subjektit ankues;
 - faktit që z. B, lidhur me këtë rast ka paraqitur kërkesë-padinë nr. 4418 Akti, datë 26.10.2021, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kundër Zyrës së KDIMDHP dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me objekt: “Fshirje të dhënash personale, kufizim aksesit në lidhje me të dhënat personale”, kërkesë-padi e cila është akoma në fazë shqyrtimi gjyqësor;
- gjykon se, nuk mund të vlerësojë faktin nëse mbajtja e të dhënës së raport ngjarjes së datës 09.06.2011 për subjektin ankues, në sistemin TIMS, është e ligjshme apo jo, përsa kohë një vlerësim i tillë është një e drejtë dhe detyrim ligjor që i atribuohet një institucioni tjetër, siç është KDIMDHP.

Në këto kushte, bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se një shqyrtim i tillë, nuk bën pjesë në kompetencat lëndore dhe fushën e veprimtarisë së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Për pasojë, ky kërkim i ankuesit nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e tij.

Në nenin 33, pika 4/b, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b) përbën abuzim me të drejtën e ankimimit para Komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”.

¹⁴ Kreu III, i këtij ligji “Administrimi i të Dhënave Personale”.

¹⁵ Hyrë në fuqi me datë 29.09.2016.

A.2.2 Lidhur me të dhënat e hedhura në sistemin TIMS dhe menaxhimin e tyre nga ana e institucionit përgjegjës, DKM, përsa i takon rekordit të datës 16.05.2018 “Kthyer deportiv nga Belgjika pasi është akuzuar për lëndë narkotike, ndalim 10 vjet”, Komisioneri vëren se:

Në kontekst të shqyrtimit të pretendimit të subjektit ankues, si dhe parashtrimeve të sjella nga ana e DKM, Komisioneri ka analizuar aktet ligjore e nënligjore, të cilat përcaktojnë strukturat përgjegjëse, procedurën e ndjekur dhe afatet, lidhur me menaxhimin e të dhënave të tilla në sistemin TIMS/SIS. Sistemi i Informimit i Schengen-it¹⁶ (SIS), është krijuar për të ndihmuar në ruajtjen e sigurisë së brendshme brenda shteteve që janë anëtare të zonës Schengen për mungesë të kontrolleve në kufijtë e brendshëm¹⁷. Është një sistem i madh i informimit që u mundëson autoriteteve policore, të migracionit, gjyqësore dhe autoriteteve të tjera që t’i fusin të dhënat dhe të konsultohen në lidhje me paralajmërimet për personat e zhdukur, personat që nuk janë shtetas të BE-së, të cilëve nuk u lejohet të hyjnë apo të qëndrojnë në zonën Schengen. Në këtë mënyrë, SIS është baza e bashkëpunimit për zbatimin e ligjit. Në të njëjtën kohë, kontribuon në masë të madhe në mbrojtjen e kufijve të jashtëm të Schengen-it.

Sistemi i Informimit Shengen, SIS-II, është gjenerata e dytë e sistemit të informacionit Shengen, e përdorur që prej 1995; funksionalitetet e saj janë perfeksionuar: mundësi për të futur të dhëna biometrike (*gjurmë gishtërinjsh dhe fotografi*), mundësi për të ndërlidhur sinjalizime të ndryshme (*p.sh, sinjalizimi i një personi dhe i një makine*). SIS-II përmban gjithashtu, kopje të mandat-arresteve europiane, të lidhura direkt me sinjalizimin e personave të kërkuar me synim arrestimin, dorëzimin, apo ekstradimin e tyre, çka do i lejojë autoriteteve kompetente, të sigurojnë një ndjekje të nevojshme, në mënyrë të thjeshtë dhe më të shpejtë.

SIS-II, siguron një mbrojtje solide të të dhënave dhe aksesit në SIS-II, është limituar vetëm për autoritetet policore dhe doganore, autoritetet e drejtësisë, autoritetet e ngarkuara me respektimin e kufijve, shqyrtimit të kërkesave për viza dhe matriculimin e mjeteve në shtetet anëtare.

Cilido person, ka të drejtë të konsultojë të dhënat, që kanë lidhje me të dhe që janë futur në SIS-II; ai mund ti kërkojë gjithashtu, autoritetit kombëtar, kompetent të korrigjojë ose të fshijë informacionet me karakter personal, që i përkasin. Çdo person, ka mundësi gjithashtu të ndërmarrë një veprim juridik, për të pasur akses në të dhënat e tij, të korrigjojë apo fshijë apo për të marrë informacione, ose një dëshmipërblim për arsye të një sinjalizimi, që ka lidhje me të. (*Pra, kur kemi të bëjmë me raste, kur informacionet nuk janë të përditësuara, apo ndonjë gabimi që mund të ndodhë në hedhjen e të dhënave në sistem*).

Autoritetet kombëtare të survejimit dhe kontrolluesi europian, i mbrojtjes së të dhënave, bashkëpunojnë në mënyrë të ngushtë, me synim të sigurojnë, një survejim të koordinuar të SIS-II.

¹⁶ Referuar tek: https://edps.europa.eu/data-protection/european-it-systems/schengen-information-system_en
https://knowledge4policy.ec.europa.eu/dataset/ds00009_en
<http://www.dataprotection.ie/en/schengen-information-system-sis-ii>

SIS-II, është një sistem i avancuar informacioni, i përbërë nga tre elementë: një sistem qendror, sistemet kombëtare të hapësirës Shengen dhe një infrastrukturë komunikimi midis sistemit qendror dhe sistemeve kombëtare.

Me 15.12.2010 ka hyrë në fuqi vendimi i Parlamentit Evropian për heqjen e vizave për shtetasit shqiptarë që udhëtojnë në shtetet e Bashkimit Evropian dhe që nga kjo datë, shtetasit shqiptarë mund të udhëtojnë pa viza në të gjitha vendet e zonës Schengen. Në këtë kontekst, nëse një shtetas shqiptar ka rekorde, të dhëna kriminale apo vepra të tjera të kryera në kundërshtim me legjislacionin evropian dhe dënime të dhëna në cilindo shtet të BE-së, këto të dhëna hidhen në SIS-II dhe mund të aksesohen nga të gjitha autoritetet kompetente (*të BE-së, por dhe shtetit shqiptar në këtë rast*) të cilat ushtrojnë kontrolle në funksion të detyrës së tyre, përfshirë dhe autoritetet e kontrollit të pikave të kalimit kufitar tokësor.

Për rrjedhojë, në rastin konkret, nëse subjekti ankues do të figuronte me rekorde në cilindo shtet të BE-së, atij do t'i rezultonin këto të dhëna në SIS-II.

Komisioneri vlerëson se, referuar shkresës me nr. 699138/1-a, datë 25.02.2020, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Atiki/Greqi, rezulton se ankuesi nuk figuron i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të të Huajve të Padëshiruar apo në Sistemin Informativ Shengen.

Ligji nr. 71/2016 *“Për Kontrollin Kufitar”*, në nenin 1 të tij, përcakton rregullat për regjimin e kontrollit kufitar të personave që kalojnë kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2, pikat 1/5/6/7 të tij, përcakton se, në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

“Kontroll kufitar” është veprimtaria që kryhet në përputhje dhe për qëllim të këtij ligji në kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë, si përgjigje posaçërisht ndaj një synimi për të kaluar ose aktit të kalimit të kufirit, pavarësisht nga rrethanat dhe që përbëhet nga verifikimi kufitar e mbikëqyrja kufitare.

“Roja kufitare” është çdo punonjës i Policisë Kufitare dhe të Migracionit, i caktuar në pikën e kalimit kufitar ose përgjatë apo në afërsi të kufirit shtetëror për të kryer detyra të kontrollit kufitar në përputhje me këtë ligj.

“Verifikim kufitar” është veprimtaria që kryhet në pikën e kalimit të kufirit për të garantuar se personat, përfshirë mjetet e tyre të transportit dhe sendet që kanë në zotërim, mund të lejohen për të hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë ose për të dalë prej tij.

“Verifikimi i vijës së dytë” është një verifikim i mëtejshëm, i cili mund të kryhet në një vend të posaçëm, tej vendndodhjes së vijës së parë, në të cilën kryhen verifikime minimale ose tërësore për të gjithë personat”.

Neni 6, i këtij ligji ka përcaktuar në mënyrë të detajuar kompetencat e Policisë Kufitare të Migracionit në Kufi, ndër të cilat, evidentohet se, rojat kufitare, në kuadër të kontrollit kufitar, janë të autorizuara të verifikojnë identitetin e personave, subjekt kontrolli, arsyen për kalimin e kufirit shtetëror, si dhe automjetet e sendet e tyre, nga jashtë dhe nga brenda. Çdo person është i detyruar të bashkëpunojë në verifikimin e identitetit e të arsyeve të kalimit të kufirit shtetëror, të mundësojë

zbatimin e menjëhershëm të kësaj mase, si dhe të sigurojë që automjeti e sendet e tij të mund të verifikohen.

Sipas përcaktimeve të këtij ligji¹⁸, të gjitha lëvizjet ndërkufitare në kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë janë subjekt i verifikimeve kufitare nga rojat kufitare dhe se, në hyrje dhe në dalje, të gjithë personat janë subjekt i verifikimit kufitar minimal¹⁹, i cili përbëhet nga:

a) verifikimi i identitetit e i shtetësisë së personit, si dhe i vlefshmërisë e i origjinalitetit të dokumentit të udhëtimit, duke përdorur pajisje teknike dhe duke u konsultuar me bazat përkatëse të të dhënave e veçanërisht me:

i) bazat kombëtare të të dhënave që përmbajnë informacion mbi dokumentet e vjedhura, të përvetësuara, të humbura dhe të zhvleftësuara të udhëtimit;

ii) bazën e të dhënave të INTERPOL-it për dokumentet e vjedhura dhe të humbura të udhëtimit;

iii) bazat ndërkombëtare të të dhënave, të njohura nga Republika e Shqipërisë;

b) verifikimi që personi, mjeti i tij i transportit dhe sendet që ai transporton nuk përbëjnë rrezik për rendin dhe sigurinë publike, shëndetin publik dhe marrëdhëniet ndërkombëtare me shtetet e tjera, duke u konsultuar me regjistrat dhe bazat e të dhënave përkatëse.

Neni 14, i ligjit nr. 71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, në pikat 6,7,8,9 të tij ka përcaktuar shprehimisht se:

“6. Personat, që janë subjekt i verifikimit kufitar minimal, në bazë të analizës së riskut dhe në mënyrë josistematike, mund t’i nënshtrohen verifikimit tërësor.

7. Nëse, nga rezultatet e verifikimit në vijën e parë, konsiderohen të nevojshme verifikime të mëtejshme, personit i kërkohet t’i nënshtrohet verifikimit në vijën e dytë, i cili mund të përfshijë verifikime të hollësishme personale, verifikime të hollësishme të sendeve në posedim dhe inspektime të hollësishme të automjetit.

8. Aty ku janë kushtet, verifikimet e vijës së dytë kryhen në ambiente të përshtatura posaçërisht për këtë qëllim.

9. Të gjithë personat, që janë subjekt i verifikimit në vijën e dytë, informohen me shkrim për qëllimin dhe procedurat që ndiqen gjatë këtij verifikimi, në një gjuhë që e kuptojnë apo që ka arsye për të besuar se e kuptojnë ose në një mënyrë tjetër efektive. Informacioni pasqyron të drejtën që ka personi, subjekt i verifikimit në vijën e dytë, për të kërkuar emrin ose numrin e identifikimit të rojës kufitare që kryen verifikimin tërësor në vijën e dytë, emrin e pikës së kalimit kufitar dhe datën kur është kaluar kufiri shtetëror. Përmbajtja e këtij informacioni përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike”.

Kreu III, i këtij ligji “Administrimi i të Dhënave Personale”, në pikën 1, të nenit 20, “Mbledhja, përpunimi dhe përdorimi i të dhënave personale”, ka përcaktuar në mënyrë të detajuar se:

“1. Policia Kufitare dhe e Migracionit ka të drejtë të mbledhë në mënyrë të drejtpërdrejtë të dhëna personale të personave që janë subjekt i kontrollit kufitar dhe:

a) të regjistrojë manualisht të dhëna;

¹⁸ Neni 13, i tij “Verifikimet kufitare”.

¹⁹ Neni 14, i tij “Verifikimi kufitar i personave”.

- b) të shënojë manualisht ose elektronikisht të dhënat në një sistem kompjuterik të përpunimit të të dhënave;
- c) të identifikojë dhe të regjistrojë të dhëna, për qëllim dhe në kohëzgjatje të verifikimeve kufitare të automatizuara, në rast të përdorimit të pajisjeve për verifikim kufitar të automatizuar;
- ç) t'i përdorë ato për kërkime, në kuptimin e menaxhimit të sigurisë dhe të aktivitetit me autoritetet e sigurisë që i shërbejnë drejtësisë penale;
- d) në raste dyshimi për një vepër penale, t'i vendosë në dispozicion të një autoriteti tjetër të sigurisë, për qëllime të zbatimit të ligjit, brenda kompetencës ligjore të atij autoriteti.
2. Vendimet për hyrjet dhe daljet depozitohen në sistem kompjuterik të përpunimit të të dhënave.
3. Rregullat për administrimin e të dhënave të grumbulluara nga zbatimi i këtij ligji përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

Në zbatim të pikës 3, të nenit 20, të ligjit nr. 71/2016 "Për Kontrollin Kufitar", Ministri i Punëve të Brendshme dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, kanë nxjerrë Udhëzimin e Përbashkët me nr. 515, datë 27.09.2016 ²⁰"Për Përpunimin e të Dhënave Personale nga Rojet Kufitare".

Ky Udhëzim përcakton se:

"1.Rojet Kufitare, në funksion të kontrollit kufitar, mbledhin të dhëna personale deri në atë masë sa është e nevojshme për identifikimin e saktë të personit që synon të kalojë, kalon, apo ka kaluar kufirin, si dhe të dokumentacionit dhe mjetit të udhëtimit që ky person synon të përdorë ose përdor për të kaluar kufirin, së bashku me motivin e kalimit të kufirit, kohën dhe vendin e saktë kur dhe ku është synuar të kalohet apo është kaluar kufiri, me qëllim garantimin e sigurisë kufitare dhe sigurisë së brendshme, si dhe parandalimin, zbulimin dhe hetimin e rasteve të migracionit të paligjshëm dhe krimit ndërkufitar.

2. Rojet Kufitare, në funksion të kontrollit kufitar, shfrytëzojnë të dhëna personale dhe konsultohen me to, deri në atë masë sa është e nevojshme për kryerjen e një kontrolli kufitar optimal, me qëllim garantimin e sigurisë kufitare dhe sigurisë së brendshme, si dhe parandalimin, zbulimin dhe hetimin e rasteve të migracionit të paligjshëm dhe krimit ndërkufitar.

3. Rojet Kufitare, në përputhje me pikën 1, mbledhin dhe regjistrojnë të dhëna personale të:
dh) personave të kthyer dhe të riatdhesuar nga autoritetet e huaja në Republikën e Shqipërisë, ose nga autoritetet shqiptare drejt një vendi tjetër.

4.Rojet Kufitare, në përputhje me pikën 1, krahas të dhënave të parashikuara në pikën 3, mund të mbledhin dhe të regjistrojnë gjithashtu, dokumentacion që përmban të dhëna personale si më poshtë:

a. Intervistat e personave të kthyer dhe riatdhesuar në Shqipëri, si dhe të personave që kanë kaluar apo tentojnë të kalojnë kufirin në mënyrë të parregullt, kur këto janë të nevojshme për zbulimin e veprave penale dhe shkeljeve administrative apo identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit;

²⁰ Hyrë në fuqi me datë 29.09.2016.

ç. Foto dhe video të siguruara me anë të pajisjeve të kontrollit kufitar, kur këto pajisje e mundësojnë manualisht ose automatikisht dhe të dhënat në fjalë janë të nevojshme për zbulimin e veprave penale dhe kundërvajtjeve administrative, apo për identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit;

d. Foto dhe video nga kamerat e sigurisë dhe pajisjet e tjera që janë të instaluar në ambientet e përdorura nga Policia Kufitare dhe e Migracionit për efekt të kontrollit kufitar.....

5. Rojet Kufitare, për efekt të kontrollit kufitar, krahas të dhënave personale dhe dokumentacionit të parashikuar në pikat 3 dhe 4, konsultojnë dhe shfrytëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm që përmban të dhëna personale:

a. shënimet, njoftimet dhe informacionet e autoriteteve ligjzbatuese, të shfaqura automatikisht ose me kërkim në sistemet elektronike, si dhe ato që mbërrijnë shkresërisht dhe që përcaktohen si të nevojshme të konsultohen dhe të shfrytëzohen gjatë kontrollit kufitar;

b. arkiva elektronike dhe shkresore që me marrëveshje, me ligj ose me vendim të autoriteteve përgjegjëse, përcaktohen si të nevojshme të konsultohen dhe shfrytëzohen gjatë kontrollit kufitar.

.....

7. Mbledhja, regjistrimi, konsultimi dhe shfrytëzimi i të dhënave të parashikuara në pikat 3 dhe 4, si dhe konsultimi dhe shfrytëzimi i të dhënave të parashikuara në pikën 5, kryhet në mënyrë të tillë që roja kufitare që i mbledh, i regjistron, konsultohet me to dhe/ose i shfrytëzon, si dhe punonjësi autorizues apo vendimmarrës për këto veprime të rojes kufitare, të jetë i identifikueshëm.

8. Të gjitha regjistrimet që kryhen në arkiva shkresore nga rojet kufitare mund të regjistrohen në arkiva elektronike, kur është marrë një vendim për krijimin e një arkivi të tillë nga autoritetet përgjegjëse.

9. Në rastet e parashikuara në pikën 8, arkivat shkresore të cilat regjistrohen në arkiva elektronike asgjësohen sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga regjistrimi në arkiv elektronik. Arkivat e mëparshme shkresore, të cilat nuk regjistrohen ose nuk mund të regjistrohen në arkiva elektronike, ruhen deri në afatin e parashikuar për anonimizim të pakthyeshëm sipas përcaktimeve të pikës 13 apo fshihen sipas përcaktimit të pikës 14.

.....

13. Të dhënat personale të mbledhura nga roja kufitare, në përputhje me pikat 3 dhe 4, anonimizohen në mënyrë të pakthyeshme kur plotësojnë këto afate:

a. 2 vjet për të dhënat e parashikuara në pikën 3, gërmat “a”, “b”, “ç”, “d”, “dh” “e”;

.....

14. Nëse anonimizimi i pakthyeshëm, i parashikuar në pikën 13, është teknikisht i pamundur, të dhënat në fjalë fshihen përfundimisht.

.....

20. Drejtorja e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin merr masat për zbatimin e afateve të parashikuara në këtë udhëzim për arkivat shkresore.

21. Struktura përgjegjëse për teknologjinë dhe informacionin, në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, merr masat për zbatimin e afateve të ruajtjes, aksesimit dhe anonimizimit të pakthyeshëm apo fshirjes së të dhënave personale që përpunohen në arkivat elektronike për efekt të kontrollit kufitar”.

Urdhri nr. 641, datë 20.12.2019 “Për forcimin e kontrollit të shtetasve shqiptarë që kalojnë kufirin shtetëror”, i Ministrisë së Brendshme, në pikën 2, të tij, ka përcaktuar shprehimisht se:

“Në funksion të kontrollit dhe verifikimit kufitar, ndaj të gjithë shtetasve shqiptarë që kanë shënime, njoftime dhe informacione të autoriteteve ligjzbatuese, të shfaqura automatikisht ose me kërkim në sistemet elektronike, si dhe ato që vijnë në formë shkresore, është e nevojshme kryerja e një kontrolli dhe verifikimi të vijës së dytë minimal ose tërësor, sipas rastit, apo të kalohet në verifikim të hollësishëm.

3. Të gjithë shtetasit shqiptarë të kategorisë “Inad”, gjatë dy viteve të fundit, nga data e paraqitjes në PKK, për shkak të masës së ndalimit të hyrjes në zonën “Schengen”, me arsyetimin “Për informacione në SIS”, “Refuzim azili”, dhe “Rrezik për sigurinë publike” dhe të gjithë shtetasit shqiptarë të kategorisë “Deportiv” gjatë tre viteve të fundit, nga data e paraqitjes në PKK, për shkak të çdo lloji arsyeje dhe janë të regjistruar në sistemin TIMS si të tillë, të mos lejohen të kalojnë kufirin shtetëror deri në paraqitjen e një dokumenti shkresor të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar, që provon se nuk kanë ndalim hyrjeje, urdhër largimi ose dëbimi në vendet e BE dhe zonën Schengen.

4. Të gjithë shtetasit shqiptarë që kanë shënime apo njoftime në sistemin TIMS dhe informacione të autoriteteve ligjzbatuese, për vepra penale (të trafikimit, falsifikimit të dokumenteve, kontrabandës, etj), të kalojnë për kontroll në vijën e dytë për dokumentet e udhëtimit, sendet dhe mjetet e transportit.

5. Kur shtetasit paraqesin dokumente justifikuese, administrative apo gjyqësore, që provojnë se nuk ka pengesë për të udhëtuar në vendet e BE dhe zonën Schengen, roja kufitare në PKK të bëjë shënimet përkatëse në sistemin TIMS tek rubrika “Shënime”. Një kopje origjinale ose fotokopje e njëzuar me origjinalin e dokumentit justifikues, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar, administrohet në PKK për një periudhë 2 vjeçare.

6. Në të gjitha rastet e kthimeve të shtetasve shqiptarë si “Inad” dhe “Deportiv”, bazuar në dokumentet që posedojnë apo të intervistimit në rastet kur ai mungon, të bëhen shënime në TIMS, në rubrikën “Shënime” për arsyen e kthimit dhe afatin e ndalimit të hyrjes në vendet e Schengen-it/BE-së, duke zbatuar procedurat e punës për regjistrimin në sistemin TIMS.

7. Në rastet që shtetasit shqiptarë nuk lejohen të dalin nga kufiri shtetëror, deri në plotësimin e kushteve të përcaktuara në këtë urdhër, të zbatohet procedura standard për regjistrimin në sistemin TIMS në modulën “Shënime”, duke reflektuar arsyet e moslejimit të përkohshëm të daljes, në aktin përkatës, sipas përcaktimeve të mëposhtme:

- a) Nuk ka dokumentacionin e duhur që justifikon qëllimin e udhëtimit dhe kushtet e qëndrimit;
- b) ka qëndruar më shumë se 90 ditë në 180 ditët e fundit, në territorin e zonës Schengen;
- c) nuk ka mjete të mjaftueshme jetese (financiare) për periudhën, kohën dhe mënyrën e qëndrimit, ose mjete financiare për kthimin në Shqipëri;
- d) është person për të cilin rezulton njoftim/informacion në sistem”.

Në Urdhrin sipërcituar, pika 3 e tij, ka përcaktuar rastet dhe mënyrën e lejimit ose jo të kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë, për dy kategoritë e shtetasve shqiptarë të cilësuar si “Inad” dhe “Deportiv”, por nuk ka shpjeguar apo përcaktuar pikërisht kuptimin e këtyre dy termave dhe se cilët shtetas shqiptarë futen në këto dy kategori.

Komisioneri vëren se, një përcaktim të këtyre dy termave ka patur në Urdhrin nr. 805, datë 01.08.2017 “Për forcimin e kontrollit të shtetasve shqiptarë që kalojnë kufirin shtetëror”, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, i cili është shfuqizuar me Urdhrin e mëvonshëm me nr. 641, datë 20.12.2019 “Për forcimin e kontrollit të shtetasve shqiptarë që kalojnë kufirin shtetëror”, të Ministrit të Brendshëm, dhe ai përcaktonte shprehimisht se:

Termi *Inad* i referohet shtetasve shqiptarë (të kthyer pas datës 01.01.2016) për shkak të masës së ndalimit të hyrjes në zonën Schengen, me arsyetimin “për informacione në SIS”, “refuzim azili” dhe “rrezik për sigurinë publike”.

Termi *Deportiv* përdoret për shtetasit shqiptarë (të deportuar pas datës 01.01.2015), për shkak të masës së ndalimit të hyrjes në zonën Schengen, të regjistruar në sistemin TIMS si të tillë, me arsyetimin “të mos lejohen të kalojnë kufirin shtetëror, kur ata do të udhëtojnë përsëri me destinacion vendet e Schengenit/BE-së, pa një dokument shkresor që provon se ka një ndalim hyrjeje, urdhër largimi, ose urdhëra dëbimi në ato vende”.

Referuar fakteve, dokumentacionit të administruar, si dhe në analizë të sa më sipër, Komisioneri konstaton se:

- Në shkresën me nr. 699138/1-a, datë 25.02.2020, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Atiki/Greqi, cilësohet se, ankuesi nuk figuron i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Huajve të Padëshiruar apo në Sistemin Informativ Shengen. Këtë shkresë ka paraqitur në pikën e kontrollit kufitar të PKK Kakavijë me datë 09.07.2021, bazuar në të cilën dhe është lënë të kalojë kufirin shtetëror në drejtim të Greqisë.
- Në të njëjtën datë që ka paraqitur ankesën e tij pranë Zyrës së KMD-së, ankuesi me shkresën me nr. 1281 prot., datë 27.07.2021 ka kërkuar para Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes të të Dhënave Personale, fshirjen e të dhënave që kanë të bëjnë me ndërrimin e emrit, gjë për të cilën është orientuar nga ana e Institucionit të KDIMDHP-së, që fillimisht ai duhet t'i drejtohej Kontrolluesit të këtyre të dhënave, pra Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- Me këkesën e datës 01.09.2021 ankuesi i është drejtuar shkresërisht Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, duke kërkuar fshirjen e shënimeve si person “deportiv” dhe “I verifikuar”.
- Nga shkresa me nr. 7036/1 prot., datë 08.09.2021 e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, evidentohet se ankuesi është informuar prej tyre se, pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur prej tij, DPPSH ka marrë masa duke fshirë shënimet si “deportiv” dhe “I verifikuar”, pasi janë plotësuar afatet e ruajtjes sipas akteve normative në fuqi.
- Një fakt i tillë është pranuar gjatë seancës dëgjimore me datë 26.10.2021 si nga ana e përfaqësuesit të DPPSH dhe pala ankuese.

Nenet 13²¹ dhe 19²², të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të ndryshuar, kanë përcaktuar shprehimisht se:

“Çdo subjekt i të dhënave ka të drejtë të kërkojë bllokimin korigjimin ose fshirjen e të dhënave, pa pagesë kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij nuk janë të rregullta, të vërteta, të plota ose janë përpunuar dhe mbledhur në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji. Kontrolluesi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës së subjektit të të dhënave, duhet ta informojë atë për përpunimin e ligjshëm të të dhënave, kryerjen ose moskryerjen bllokimit e korigjimit apo të fshirjes.

Kontrolluesi kryen vetë ose me kërkesë të subjektit të të dhënave bllokimin korigjimin ose fshirjen e të dhënave personale, kur vëren se janë të parregullta, të pavërteta, të paplota ose janë përpunuar në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji. Kontrolluesi, brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës së subjektit të të dhënave, informon subjektin e të dhënave për kryerjen apo moskryerjen bllokimit e korigjimit ose të fshirjes. Kontrolluesi informon marrësin e të dhënave personale për korigjimin ose fshirjen e të dhënave personale, të transmetuara para korigjimit apo fshirjes”.

Pra, bazuar në sa më lart, Komisioneri vëren se, në respektim të përcaktimeve ligjore të akteve normative që rregullojnë procedurën për heqjen e shënimeve të tilla, si “deportiv”, nga ana e institucionit përgjegjës, që është DPPSH, njëherësh dhe Kontrolluesi i këtyre të dhënave, është respektuar si e drejta e ankuesit për fshirjen e kësaj të dhëne, po ashtu dhe detyrimi ligjor i Kontrolluesit lidhur me sa ka kërkuar ankuesi, pasi ata me të marrë kërkesën e tij dhe me verifikimin e plotësimit të afateve të parashikuara në nenin 13 dhe 19, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të ndryshuar, kanë marrë masat për garantimin e të drejtës për fshirjen e të dhënave sipas parashikimeve të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe legjislacionit specifik për kontrollin kufitar.

Për rrjedhojë, në analizë të sa më sipër, Komisioneri gjykon se, nga ana e DKM, nuk ka patur veprime të padrejta, të pafavorshëm apo të paligjshme lidhur me sa ka pretenduar ankuesi.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktimi e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se ankuesi nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e DKM.

²¹ Pikat 1 dhe 2, të tij.

²² Pikat 1,23, të tij.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e DKM, për shkakun e pretenduar nga subjekti ankues.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 3, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 20, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 10-11, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetasit A. B, për shkaqet e pretenduara prej tij²³, nga ana e Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
2. Mospranimin e ankesës të shtetasit A. B, lidhur me mbajtjen e të dhënës “Raport ngjarje të vitit 2011” në sistemin TIMS, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për shqyrtimin e saj.
3. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Të mira dhe shërbime
Shkaku: Çdo shkak tjetër
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim

²³ Gjendjes civile dhe të dhënës, shënimit “Deportiv”, klasifikuar si: “çdo shkak tjetër”.